

VENDIM
Nr. 181, datë 13.7.2022

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “NRG POWER” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

(Ndryshuar me vendimin nr. 198, datë 3.8.2022)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, dhe nenit 13, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.7.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1118/1 prot., datë 12.7.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘NRG Power’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 130, datë 31.5.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- ERE me shkresën nr. 70/23 prot., datë 31.5.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta (datë 14.6.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 673/1 prot., datë 6.6.2022, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacionin dhe informacionin plotësues me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 673/2 prot., datë 10.6.2022, dhe nr. 673/4 prot., datë 27.6.2022.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë për tregtimin e energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik dhe administrativ; dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim – neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “e”;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”;
- dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b” dhe “c”.
- Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e gjykatës për administratorin e saj brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijeni e këtij vendimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licençojë shoqërinë “NRG Power” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. *Shfuqizuar.*

3. *Shfuqizuar.*

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti